

I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall vende pune për personel akademik të kategorisë “Lektor” dhe “Asistent-lektor”, si dhe për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike si më poshtë:

A. 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë i kategorisë “Asistent-lektor” në përmbulimin e seminareve si me poshtë:

- Fizikë Teknike, lëndë e cila zhvillohet në pesë fakultete të UPT;
- Makina Fluide;
- Makina dhe Sisteme Energjitike;
- Fluidodinamikë
- Disiplina të tjera sipas nevojave të departamentit.

Kandidati për personel akademik me kohë të plotë i kategorisë “Asistent-lektor” në Departamentin e Energjitikës, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet në Inxhinieri Mekanike, profili Energjitikë (sistemi 5 vjeçar ose 3 + 2, Bachelor + Master i Shkencave);
2. Të kenë notë mesatare të ponderuar të studimeve universitare jo më të ulët se 8 (tetë);
3. Të kenë eksperiencë në mësimdhënie universitare;
4. Studimet pasuniversitare brenda ose jashtë vendit (SHPU ose Masteri i Nivelit të Dytë) përbëjnë avantazh;
5. Të kenë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.

B. 1 (një) vend pune për personel akademik me kohë të plotë i kategorisë “Asistent-lektor” në Departamentin e Prodhim Menaxhimit për lëndët:

- **Impiantet në Industrinë e Materialeve**, cikli Bachelor në Inxhinieri e Materialeve, viti II, Sem. 2 (leksione, seminare, laboratore)
- **Metodat e Studimit dhe Kontrollit të Materialeve**, cikli Bachelor në Inxhinieri e Materialeve, viti III, Sem. 1 (leksione, seminare)
- **Shkenca dhe Teknologjia e Materialeve**, cikli Bachelor në Inxhinieri e Materialeve, viti II, Sem. 1 (seminare, laboratore)
- **Shkenca e Materialeve**, cikli Bachelor në Inxhinieri e Ekonomike, viti II, Sem. (laboratore, seminar 1 grup).

Kandidati për personel akademik me kohë të plotë i kategorisë “Asistent-lektor” në Departamentin e Prodhim Menaxhimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të kenë përfunduar studimet në Inxhinieri Materiale në Shqipëri ose jashtë vendit në sistemin 5 vjeçar ose sistemin 3 + 2 (Bachelor + Master i Shkencave);
2. Të kenë notë mesatare të studimeve universitare (3+ 2) mbi 8.5;
3. Të kenë eksperiencë pune në mësimdhënie në 5 vitet e fundit;
4. Të kenë eksperiencë pune mbi 5 vjet në industri, në fushën e inxhinierisë së materialeve, preferohet në prodhim dhe përpunim të materialeve metalike;
5. Të zotërojnë me dëshmi/certifikatë një gjuhë të huaj (preferohet anglisht);
6. Preferohen kandidatët me trajnime dhe certifikime në aspekte të impiantistikës dhe provave të kontrollit të materialeve;
7. Preferohen kandidatët me eksperiencë në kërkimin shkencor;
8. Të kenë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.

C. 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant me arsim të lartë” pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit.

Kandidati për personel ndihmësakademik në pozicionin “Laborant me arsim të lartë” pranë Departamentit të Prodhim Menaxhimit, Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të Dytë “Master i Shkencave/ Master Profesional” në programin/et e studimit në Inxhinieri Materiale dhe/ ose Inxhinieri Mekanike;
2. Të ketë notë mesatare të dy cikleve të studimit (3+2) mbi 7 (shtatë);
3. Të ketë njohuri në pajisjet laboratorike si dhe në fushat e kërkimit shkencor dhe të karakterizimit të materialeve inxhinierike veçanërisht: *të ketë njohuri në përdorimin e mikroskopisë optike, të ketë njohuri për vlerësimin dhe provat e vetive mekanike të materialeve inxhinierike, të shoqëruara me vërtetim për zbatueshmërinë e provave pa shkatërrim; preferohet të ketë eksperiencë mbi dy vite, si dhe të ketë njohuri për teknikat e avancuara të provave dhe analizave të materialeve;*
4. Preferohen kandidatët me njohuri mbi standardet ndërkombëtare. Aftësi dhe zbatueshmëri për standartin ISO 17025 (laborator testues dhe kalibrues);
5. Të zotëroj njohuri në gjuhën angleze;
6. Të ketë aftësi të mira bashkëpunuese dhe komunikuese me personelin akademik dhe ndihmës akademik.

D. 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Sekretare mësimore” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike.

Kandidati për personel ndihmësakademik me karakter administrativ në pozicionin “Sekretare mësimore” pranë Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike duhet të plotësojë kriteret përcaktuese si më poshtë:

1. Të ketë arsim të lartë në fushën e drejtësisë ose shkencave sociale. Nota mesatare e studimeve përbën avantazh;
2. Preferohet të ketë njohuri në fushën e Administratës Publike;
3. Të kenë eksperiencë pune mbi 3 vite;
4. Të kenë njohuri shumë të mira të programeve bazë kompjuterike: Word, Excel, etj;
5. Të ketë aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi në grup.

II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje e gradës shkencore “Doktor”;
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj e noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **22.09.2023** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.